



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislacioni i IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Seanca Nr. 81

Prishtinë, 03.12.2013, duke filluar nga ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në seancë morën pjesë: Jasmina Zhivković, Albert Kinolli, Lumnije Morina, Lirije Kajtazi, Vesna Mikić, Jelena Bontić, Mufera Shinik, Rasim Demiri dhe Mursel Halili

Munguan: Elmi Reçica, Petar Miletić dhe Glauk Konjufca

Pjesëmarrësit tjerë: përfaqësuesit e OSBE, ECMI, RTK, ZPRK, KKK, OHCR

Personeli ndihmës i komisionit: Koordinator i komisionit

Seancën e kryesoi: kryetarja e Komisionit, zonja Jasmina Zhivković

Për seancë u propozua ky :

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Shqyrtimi në parim i P/ligjit Nr. 04/L-235 për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, Nr. 03/L-047
3. Shqyrtimi në parim i P/ligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje, Nr. 04/L-188, me raportin e Komisionit funksional për bujqësi, pylltari, mjedis dhe planifikim hapësinor me amendamente
4. Të ndryshme

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja konstatoi se rendi u miratua pa vërejtje dhe hapi mbledhjen me pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Shqyrtimi në parim i P/ligjit Nr. 04/L-235 për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, Nr. 03/L-047

Kryetarja - dha një koment të shkurtër hyrës për obligimin, qëllimin dhe domosdonë e shqyrtimit, kurse anëtarët e komisionit i njoftoi se për analizën dhe shqyrtimin më të hollësishëm, kompetent është komisioni funksional Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim dhe se konform nenit. 56.2 të Rregullores së punës së Kuvendit, duhet ta shqyrtojmë në parim, para se ky të shqyrtohet në seancën plenare, dhe pas shqyrtimit duhet të paraqesim raportin me rekomandime për miratimin ose jo në parim të këtij projektligji.

Meqenëse nuk pati vërejtje, kryetarja konstatoi se komisioni njëzëri miratoi këtë

Konkluzion

1. Miratohet në parim i Projektligji për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, Nr. 03/L-047

Pastaj kryetarja e hapi diskutimin sipas pikës së tretë të rendit të ditës:

2. Shqyrtimi në parim i P/ligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje, Nr. 04/L-188, me raportin e Komisionit funksional për bujqësi, pylltari, mjedis dhe planifikim hapësinor me amendamente

Meqenëse nuk pati vërejtje në raportim me amendamentet e komisionit funksional, Komisioni, nga aspekti i të drejtave dhe interesave të komuniteteve njëzëri miratoi këtë:

Konkluzion

1. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim shqyrtoi në parim P/ligjin për trajtimin e ndërtimeve pa leje, Nr. 04/L-188, me raportin e Komisionit funksional për bujqësi, pylltari, mjedis dhe planifikim hapësinor me amendamente, dhe konstatoi se i njëjti nuk i cenon të drejtat dhe interesat e komuniteteve, prandaj Kuvendit ia rekomandon miratimin e tij së bashku me amendamente.

1. Të ndryshme

Kryetarja njoftoi Komisionin se, po qe se iniciohet futja e një vije të veçantë buxhetore për financimin e komuniteteve pakicë në Ligjin për Buxhetin e vitit 2014, shumë shpejt do mbahet edhe një seancë e Komisionit, por që për këtë do të njoftoheni në kohën e duhur.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetje të Komisionit

Kryetare e Komisionit

Jasmina Živković